



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 687 Akti

Nr. 683 Vendimi
Tiranë, më 10.7.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 7.7.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Perparim Vukaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, përfaqësuar me prokurorë të posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.5.2023, nga av. A. N.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi përfaqësuesin ligjor të subjektit në seancën dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

i. Z. Perparim Vukaj është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

ii. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Perparim Vukaj i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Xhensila Pine (relatore).

iii. Nga Komisioni janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

iv. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, kreu hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Pamela Qirko dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

v. Trupi gjykues me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Perparim Vukaj vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit lidhur me këtë kriter, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45 – 47 dhe 35 – 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon për marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

vi. Në datën 5.6.2023, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, duke iu caktuar afat për sjelljen e provave dhe shpjegimeve, për të provuar të kundërtën e barrës së provës deri në datën 21.6.2023.

vii. Në datën 21.6.2023, subjekti nëpërmjet përfaqësuesit ligjor depozitoi shpjegimet dhe provat në funksion të barrës së provës, kërkoi kohë shtesë për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera dhe riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, si dhe për të dyja kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale. Kjo kërkesë u paraqit edhe në seancë dëgjimore.

viii. Në përgjigje të kërkesës, Komisioni njoftoi subjektin mbi kohën shtesë për të paraqitur provat dhe shpjegimet, duke e caktuar afatin e ri deri në datën 29.6.2023.

ix. Trupi gjykues ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore në datën 7.7.2023, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, Tiranë.

x. Trupi gjykues, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit gjatë përgjigjeve të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, si dhe për të dyja kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale pasi vlerësoi se për komponentin e pasurisë provat kishin nivelin e provueshmërisë sipas parashikimeve ligjore të ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti me shpjegimet dhe provat e paraqitura nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

xi. Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Perparim Vukaj vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

I. SEANCA DËGJIMORE

xii. Në datën 7.7.2023, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

xiii. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 10.7.2023, ora 9:45.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI

xiv. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Perparim Vukaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit ka arritur në konkluzionet se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

xv. Komisioni kreu një hetim të pavarur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet nr. 2 dhe 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, në të dhënat e pasqyruara dhe përfundimet e nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

xvi. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore të administruara dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar si vijon:

1. Apartament banimi me sipërfaqe 124 m², në rrugën “**”, Tiranë**

1.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament banimi me sipërfaqe 124 m², rruga “****”, shk. ***, k. ***, ap.***, Tiranë. Si burim për këtë pasuri ka deklaruar: “Dhuruar nga vëllai T. V. në vitin 2011, vlera 15.252.000 lekë”.*

1.2. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit në të dhënat konfidenciale (dhurata) ka deklaruar: “*Apartament banimi me sipërfaqe 124 m², datë 27.12.2011, Tiranë, vëllai T. V.; vlera e dhuratës: 15.252.000 lekë”.*

1.3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, me shkresën nr. *** prot., datë 8.3.2021, informon se në emër të z. Perparim D. Vukaj figuron e regjistruar pasuria apartament me sipërfaqe 124 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***.

1.4. Lidhur me historikun e krijimit të kësaj prone rezulton se me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.2.2011, pranë zyrës së noteres V. S., pala shitëse A. C. i shtet palës blerëse T. V. apartamentin me sip. 124 m², ndodhur në Tiranë, në vlerën 13.020.000 lekë, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Kjo pasuri është rivlerësuar kundrejt vlerës 15.252.000 lekë në datën 15.12.2011, para se t’i dhurohej subjektit të rivlerësimit.

1.5. Me aktin e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.12.2011, pranë zyrës së noteres V. S., z. T. V. i dhuron vëllait të tij Perparim Vukaj apartamentin me sip. 124 m², në rrugën “****”, sh.***, k. ***, ap. ***, Tiranë.

1.6. Komisioni kërkoi pranë zyrës së noteres V. S. kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.10.2008, me palë shitëse A. C. dhe palë blerëse T. V. për blerjen e apartamentit në z. k. ***, nr. ***, vol. ***, f. ***, sip. 124 m², e ndodhur në rrugën “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, kundrejt çmimit prej 12.102.400 lekësh dhe në këtë kontratë është referuar se çmimi është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

1.7. Në pyetësin nr. 2, subjekti në lidhje me kohën, vlerën e blerjes, mënyrën e likuidimit të çmimit të blerjes së kësaj pasurie, si dhe burimin e të ardhurave të z. T. V. ka deklaruar se: “*Data e blerjes nga vëllai është 22.2.2011, vlera e blerjes së apartamentit është 13.020.000 lekë dhe mënyra e likuidimit të blerjes së apartamentit është bërë cash*”. Në lidhje me burimin e të ardhurave subjekti deklaroi se: “*Burimi i të ardhurave për blerjen e pronës nga vëllai T. V. ka qenë puna në emigracion nga viti 1992 dhe nga viti 1999 e në vazhdim në Amsterdam (Holandë)*”.

1.8. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“...Në lidhje me të ardhurat e vëllait tim T. V. ju kemi dërguar dokumentet që disponojmë, kontratat e punës që nga viti 1999, vëllai është në emigracion që nga viti 1992, dhe të ardhurat përpara vitit 2008 sipas tij nuk ruhen nga organet tatimore dhe nuk mund të administrohet dokumentacion për to”*.

1.9. Ndodhur nga njëra anë para një kontrate të nënshkruar me marrëveshje dhe vullnet të plotë para noterit, e cila ka përcaktuar qartë kushtet e shitblerjes dhe likuidimit të çmimit, faktet e parashtruara nga subjekti lidhur me kohën e pagimit të çmimit janë në kundërshtim me kontratën e firmosur në vitin 2008, ku palët deklaruan para noterit se kanë paguar për këtë pasuri para nënshkrimit të kontratës vlerën prej 12.102.400 lekësh.

1.10. Në lidhje me burimin e të ardhurave të vëllait për të paguar shumën 12.102.400 lekë në vitin 2008, subjekti ka depozituar dokumentet që disponon, të cilat nuk provojnë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume nga ana e vëllait të subjektit dhe njëkohësisht dhuruesit të kësaj pasurie sipas detyrimeve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

1.10.1. Nga verifikimi në sistemin TIMS, gjithashtu rezulton se vëllai i subjektit, njëkohësisht dhurues i pasurisë, nuk ka qenë prezent në Shqipëri në asnjërën prej ditëve të kryerjes së këtyre veprimeve noteriale, në datat 3.10.2008, 22.2.2011 dhe 27.12.2011.

1.11. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të ardhurat e ligjshme të përdorura për blerjen e kësaj pasurie nga dhuruesi i saj, për të provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo pasuri nuk është pasuri e fshehur e subjektit, duke e vendosur atë në situatën faktike të parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, referuar rrethanave si vijojnë:

- i) Kontratat e shitjes në vitin 2008 dhe 2011 për këtë apartament u kryen kur blerësi nuk ishte prezent në Republikën e Shqipërisë.
- ii) Kontrata e dhurimit në vitin 2011 për këtë apartament u krye kur dhuruesi nuk ishte prezent në Republikën e Shqipërisë.
- iii) Ka mungesë të burimit të ligjshëm të të ardhurave të vëllait në shumën 12.102.400 lekë, në datën 3.10.2008, kohë kur u nënshkrua kontrata e shitblerjes së apartamentit nr. ***.
- iv) Aktet noteriale, nënshkruar para noterit, duken si përpjekje të subjektit për të fabrikuar akte që do të justifikonin krijimin e pasurive nga subjekti i rivlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.12. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti deklaroi se: *“Sistemi TIMS në fillimet e veta ka pasur shumë probleme të funksionimit, edhe aktualisht shfaq probleme bllokimi nga faktorë të ndryshëm nga mungesa e internetit e deri në ndërhyrje hakeruese.*

Nuk kam pasur dijeni për ekzistencën e një marrëdhënieje mes palëve kontraktuese për këtë pasuri të dhuruar nga vëllai më 3.10.2008 (rreth 2 vjet e 4 muaj përpara), me çmimin 12.102.400 lekë. Në logjikën time, besoj se nuk janë paguar paratë në kontratën e parë apo në vitin 2008, pasi nuk i ka pasur apo disponuar blerësi, përndryshe si do të shpjegohej fakti që blerësi bën certifikatën e pronësisë në vitin 2011, apo fakti tjetër që blerësi i rritet çmimi gati me një milion lekë (të rinj). Pra, që blerësi i ka ofruar me vonesë paratë, prandaj është bërë edhe rritja e çmimit dhe kontrata tjetër në vitin 2011, kontratë e cila është likuiduar nga blerësi dhe ka marrë fuqi ligjore”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.13. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të

administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e përfaqësuesit ligjor në seancën dëgjimore, arsyeton se:

1.14. Sipas pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike dhe në deklaratën *Vetting*, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë saktësisht dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

1.15. Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të përmbysë barrën e provës, duke mos provuar se ka deklaruar saktësisht dhe shpjeguar bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, pasi ka një sërë rrethanash që nuk mund të injorohen dhe të konsiderohen si joekzistente dhe burojnë nga burime të njohura të provës, referuar parashikimit të pikave 5 dhe 49 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe të cilat nuk u arritën të shpjegohen nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e barrës së provës, si më poshtë arsyetuar:

i) Lidhur me sa kontratat e shitjes në vitin 2008 dhe 2011 dhe kontrata e dhurimit në vitin 2011 për këtë apartament u kryen kur blerësi nuk ishte prezent në Republikën e Shqipërisë

1.16. Së pari, nga ana e subjektit nuk u arrit të shpjegohet mungesa në territorin e Republikës së Shqipërisë e blerësit të kësaj pasurie, i cili është vëllai i subjektit, njëkohësisht edhe dhuruesi i kësaj pasurie në kohën e nënshkrimit të kontratave dhe akteve noteriale lidhur me këtë pasuri.

1.17. Trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit në lidhje me mosfunksionimin e sistemit TIMS nuk janë të mbështetura në fakte dhe prova. Në përgjigje të barrës së provës dhe në seancën dëgjimore subjekti dhe përfaqësuesi i tij ligjor nuk paraqiti asnjë dokumentacion mbështetës provues për mosfunksionim të sistemit TIMS dhe zëvendësimin e tij me regjistrim manual në rastet e pretenduara.

ii) Lidhur me mungesën e burimit të ligjshëm të të ardhurave të vëllait, në shumën 12.102.400 lekë, në datën 3.10.2008

1.18. Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë edhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nga ana e dhuruesit. Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit, trupi gjykues për blerësin e kësaj pasurie vlerësoi së pari momentin e fitimit të pronësisë së apartamentit objekt gjykimi me sip. 124 m².

1.19. Bazuar në vendimin unifikues nr. 1, datë 6.1.2009, të Kolegjeve të Bashkuara, i cili referon se *"Në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se "Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi I kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qënien e tij si pronar mbi këtë pasuri.*

Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë tek të tretët. Kontrata e cila nuk është e regjistruar është e perfeksionuar dhe e vlefshme dhe ka efektet thelbësore".

trupi gjykues vlerësoi se veprimi juridik për kalimin e pronësisë së apartamentit është bërë i vlefshëm që në datën 3.10.2008, për sa është provuar se që në këtë datë plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara në nenet 79, 663 e 659 të Kodit Civil¹.

¹ Neni 79 parashikon se: *"Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile. Veprimi juridik mund të jetë i njëanshëm ose i dyanshëm".*

1.20. Neni 690 i Kodit Civil përcakton se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”* dhe neni 253 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: *“Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”*.

1.21. Lidhur me pretendimet e subjektit dhe përfaqësuesit të tij ligjor për pagimin e shumës për blerjen e kësaj prone në vitin 2011, trupi gjykues vlerëson se për sa pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie, blerësi i saj bëhet pronar i ligjshëm që në momentin e nënshkrimit të kontratës, në rastin konkret në datën 3.10.2008, datë në të cilën blerësi ka fituar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri.

1.22. Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave, njëkohësisht pronar i pasurisë së paluajtshme, legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrejt të tretëve, ndaj dhe për sa më sipër arsyetuar trupi gjykues vlerëson se rezultoi e provuar se pagimi i çmimit të blerjes së apartamentit është kryer në datën 3.10.2008, referuar aktit juridik kontratë shitblerjeje nënshkruar mes palëve, dhe se hartimi i kontratës mes palëve për të njëjtën pasuri nuk e rrëzon konkluzionin e mësipërm referuar dhe se neni 690 i Kodit Civil përcakton se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”*.

1.23. Trupi gjykues vëren se *së pari* dokumentacioni i depozituar gjatë hetimit dhe pas kalimit të barrës së provës nuk ka asnjë vlerë provuese në formën e paraqitur, pa vulë apostile, pa përkthim, pa u vërtetuar nënshkrimi i përkthyesit nga noteri publik. Pra, në kushtet kur një akt shkresor është mbajtur dhe lëshuar në territorin e një shteti tjetër dhe në gjuhë të huaj, duhet të respektohen elementet formale për vlefshmërinë e tij, të përcaktuara në parashikimet e Konventës së Hagës, datë 5.10.1961, apo parashikimet e nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile, i cili kërkon që: *“Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent”*.

1.24. *Së dyti* edhe në një analizë të dokumentacionit që subjekti ka vënë në dispozicion për të ardhurat në Holandë në vitet 1999 – 2008 lidhur me të ardhurat e tij dhe duke llogaritur shpenzimet dhe kostot e jetesës referuar të dhënave në Eurostat, vëllai i subjektit të rivlerësimit rezultoi se nuk ka pasur mundësi financiare që me burime të ligjshme të kursejë vlerën prej 12 milionë lekësh deri në vitin 2008.

iii) Lidhur me konstatimin se aktet noteriale të nënshkruara para noterit duken si përpjekje të subjektit për të fabrikuar akte që justifikonin krijimin e pasurive prej tij

1.25. Neni 681 i Kodit Civil, i cili parashikon se kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si edhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës, vlera provuese e kontratës duhet të vlerësohet dhe çmohet, duke e interpretuar atë sipas qëllimit të palëve.

1.26. Organet e rivlerësimit kanë pranuar në jurisprudencën e tyre të konsiderojnë të pavërteta elementet e deklaruara në kontrata të ndryshme, në të cilat kanë marrë pjesë subjektet e

Neni 663 parashikon se: *“Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”*.

Neni 659 parashikon se: *“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*.

rivlerësimit, pavarësisht faktit se ato kanë qenë deklarime të bëra para një noteri publik dhe nuk kanë qenë kontestuar prej palëve, pikërisht se për shkak të veçorisë së këtij procesi jo me natyrë civile të pastër, vlerësimi dhe gjykimi i çështjeve mund të bëhet në zbatim të normave procedurale të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të zbatueshme në përputhje me parashikimin referues që bën pika 6 e nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

1.27. Në këtë kontekst, duhen konsideruar edhe dispozitat e Kodit Civil për interpretimin e kontratave, për sa kohë që palët deklarojnë një qëllim të caktuar në përpilimin e tyre në formën dhe përmbajtjen që rezulton se kanë, edhe për shkak se ky qëllim i deklaruar i palëve nuk mbështetet në të dhënat e përfuara nëpërmjet burimeve të tjera të provës.

1.28. Kontratat e shitblerjes lidhur mes palëve para autoritetit publik, si noteri në rastin konkret, pa qenë prezent pala blerëse, vëllai i subjektit dhe njëkohësisht dhuruesi i kësaj pasurie, duken si përpjekje e subjektit për t'i fabrikuar këto akte.

1.29. Trupi gjykues vlerëson se nga faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, nënshkrimi i akteve noteriale kur blerësi e dhuruesi nuk ishte prezent në territorin e Republikës së Shqipërisë, passjell konkluzionin që vërtetësia e thënieve dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* lidhur me burimin e krijimit nuk janë në pajtueshmëri me provat dhe besueshmërinë e tyre, në zbatim të përcaktimit të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

1.30. Sa më sipër analizuar, në vlerësim të trupit gjykues është konfirmuar përpjekja e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave, që lidheshin me justifikimin e burimeve dhe veprimet noteriale të hartuara pa qenë prezent vëllai i tij (blerësi) dhe dhuruesi, që janë hartuar vetëm në funksion të sa më sipër.

1.31. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues, në përfundim të analizës ligjore, pasi shqyrtoi dhe analizoi të gjitha provat, arrin në konkluzionin se nuk u provua nga subjekti ligjshmëria në formë dhe përmbajtje e mënyrës së përfitimit të kësaj pasurie dhe se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk ishin në pajtueshmëri me provat dhe legjislacionin në fuqi. Trupi gjykues, në analizë të provave, konstatoi se subjekti është përpjekur të fshehtë të vërtetën, për sa i takon të dhënave që lidhen me justifikimin e burimeve të të ardhurave përdorur për këtë pasuri të paluajtshme.

1.32. Përpjekja e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave, që lidhen me justifikimin e burimeve të kësaj pasurie e vendosin subjektin në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 dhe pikës 5, shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

1.33 Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur t'i provojë trupit gjykues se nuk gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84.2016, që lidhen me fshehjen e burimit të kësaj pasurie, në funksion të shmangies së kontrollit të burimit të pasurive të tij.

2. Apartament banimi me sipërfaqe 68 m², në Pogradec, blerë nga bashkëshortja

2.1. Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja e tij, ka deklaruar: “Apartament banimi me sip. 68 m², rruga “****” nr. ***, Pogradec (kontratë sipërmarrjeje datë 14.1.2009). Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., datë 3.10.2016, vlera e blerjes 1.890.000 lekë. Marrë hua për blerjen e këtij apartamenti shuma 1.700.000 lekë, pa interes, vëllait Sh. M. në vitin 2009, nr. i kontratës së huas ***, datë 18.11.2009. Kjo hua është likuiduar nga viti 2009 deri në vitin 2015”.

2.2. Tek të dhënat konfidenciale të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Sh. M. (vëllai), marrë hua në shumën 1.700.000 lekë, të ardhura nga biznesi”.

2.3. Kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij në asnjë nga deklaramet periodike të viteve 2009 – 2016, pavarësisht pagimit të së gjithë vlerës së saj që në janar të vitit 2009.

2.3.1. Në DIPP-në e vitit 2016 në ndryshimet e pasurisë subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk e kanë deklaruar këtë pasuri, ndonëse kishin lidhur kontratën e shitblerjes datë 3.10.2016.

2.4. Mosdeklarimi i subjektit dhe i personit të lidhur mbi këtë pasuri nga viti 2009 e në vijimësi jo vetëm është në shkelje të detyrimit ligjor, të përcaktuar nga neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, por edhe pengon hetimin e saj nga organi kompetent.

2.5. Me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.1.2009, bashkëshortja e subjektit, znj. P. V., ka porositur pranë sipërmarrësit, shoqërisë “****” sh.p.k., Pogradec, një apartament banimi me sip. 63 m², në katin e pestë të banimit.

2.6. Çmimi i apartamentit në shumën 1.890.000 lekë, referuar kontratës së shitblerjes së vitit 2016, u pagua nga pala blerëse P. V. tek pala shitëse në datën 14.1.2009 në momentin e redaktimit të kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., dhe sipas mandatarkëtimit, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., që i bashkëlidhet kësaj kontrate shitjeje me përshkrimin “Depozitim blerjeje apartamenti nga znj. P. V.”.

2.7. Me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol./***, datë 3.10.2016, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse P. V., shtetasja P. V. blen apartamentin me sip. 68 m², ndodhur në Pogradec, Lagjja Nr. ***, rruga “****”, shk.***, k.***, ap.***, kundrejt çmimit 1.890.000 lekë.

2.8. Në pyetësin nr. 3, subjekti në lidhje me mosdeklarimin e kësaj pasurie si adresë banimi deklaroi se: *“Nuk e kam deklaruar si adresë banimi deri në vitin 2016, pasi nuk kemi jetuar në këtë banesë. Në vitin 2013 jam transferuar nga Korça në Tiranë dhe në këtë banesë kemi shkuar vetëm gjatë pushimeve verore ose ndonjë fundjavë”.*

2.9. Në lidhje me faktin që apartamenti i porositur nga bashkëshortja në vitin 2009 dhe kontrata e energjisë elektrike daton në vitin 2010, por subjekti deklaroi se deri në vitin 2013 ka qëndruar me qira në të njëjtin qytet, në adresën Lagjja Nr. ***, rruga “****”, subjekti në pyetësin nr. 3 deklaroi se: *“Lidhja e kontratës së dritave në vitin 2010 nuk lidhet domosdoshmërisht me faktin e banimit në këtë adresë pasi, siç shpjegova, ne nuk kemi banuar në këtë shtëpi.”*

2.10. Në pyetësin nr. 3, në lidhje me vlerën e apartamentit që referuar EKB-së së vitit 2009 për qytetin e Pogradecit do të ishte 2.900.000 lekë dhe çmimi i dakordësuar midis bashkëshortes së tij dhe shoqërisë së ndërtimit është 1.890.000 lekë, subjekti deklaroi se: *“Çmimi i deklaruar ka qenë ai i dakordësuar mes bashkëshortes dhe shitësit (shoqëria “****” sh.p.k.). Unë nuk mund të them se përse e ka shitur pronari me atë çmim, pasi nuk kemi pyetur se sa ka qenë vlera referuar nga EKB-ja. Çmimet varionin nga pozicioni i banesës dhe vendi i ndërtimit. Këtë apartament e kemi deklaruar që kur kemi bërë kontratën e sipërmarrjes në vitin 2009 dhe në vitin 2016, kur jemi bërë pronarë të kësaj pasurie në datën 3.10.2016”.*

2.11. Pala shitëse i shet palës blerëse apartamentin me sip. 68 m², ndodhur në Pogradec, Lagjja Nr. ***, rruga “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, kundrejt çmimit prej 1.890.000 lekësh.

2.12. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, në ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, subjekti dhe personi i lidhur me subjektin (bashkëshortja) nuk kanë deklaruar ndryshime në pasuri. Në detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, personi i lidhur deklaroi: *“Marrë hua për blerjen e një apartamenti banimi në shumën prej 1.700.000 lekësh”.*

2.13. Në datën 18.11.2009, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, me kontratën e huas nr. *** rep., nr. *** kol., ka marrë hua nga vëllai i saj Sh. M. Sipas kontratës së huas, huadhënësi

deklaron se i jep hua huamarrëse një shumë prej 1.700.000 lekësh për një afat 10-vjeçar, duke nisur ky afat nga data 18.11.2009. Shuma prej 1.700.000 lekësh i është dorëzuar huamarrësit para redaktimit të kontratës jashtë zyrës së noterisë.

2.14. Me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2021, FSHU-ja informon se me gjeneralitetet P. N. V., referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi me nr. ***, në instancën Pogradec.

2.15. Komisioni ka kërkuar sërish informacion pranë FSHU-së dhe, në përgjigje të kërkit, FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 13.4.2023, informon se referuar sistemit të faturimit kontrata nr. ***, me kod klienti ***, i përket abonentit L. S. P., kontratë e hapur në datën 19.9.2010. Është bërë ndryshim emri në datën 5.10.2021 nga shtetasit P. V. në L. P.. Bashkëlidhur detajet e abonentit, detajet e faturimit, detajet e pagesave, si dhe dokumentacioni që disponojnë nga sistemi.

2.16. Bashkëlidhur dokumentacionit ligjor të FSHU-së ndodhet certifikata e pronësisë për pasurinë me nr. ***, apartament me sip. 68 m², z. k. ***, në Pogradec, rruga "****", Lagjja Nr. ***, ap. ***, në emrin e bashkëshortëve L. dhe L. P., që janë bashkëpronarë me ½ pjesë secili. Certifikata e pronësisë ka dalë më 15.9.2021.

Analizë e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, si dhe mundësia financiare

2.17. Si burim për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj pasurie bashkëshortja e subjektit ka deklaruar një hua në shumën 1.700.000 lekë, pa interes, marrë në vitin 2009 nga vëllai i saj Sh. M.

2.18. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 25.1.2016, subjekti ka deklaruar se: *“Në lidhje me të ardhurat e huadhënësit Sh. M., sqaroj se personi në fjalë ka aktivitet biznesi si person fizik “****” pranë Ministrisë së Drejtësisë. Huaja është marrë për blerje apartamenti në qytetin e Pogradecit me sipërfaqe 63 m², me vlerë rreth 1.700.000 lekë, blerë me kontratë sipërmarrjeje”*.

2.19. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti në lidhje me burimin e të ardhurave, si dhe kohën, mënyrën e marrjes së huas, ka deklaruar se: *“Burimi i të ardhurave është shuma prej 1.700.000 lekësh, marrë hua nga bashkëshortja P. V. vëllait të saj Sh. M. dhe 189.000 janë paguar nga kursimet nga paga ime dhe e bashkëshortes. Shuma prej 1.700.000 lekësh është marrë hua nga bashkëshortja në janar të vitit 2009, para datës 14.1.2009, por është formalizuar me akt noterial në datën 18.11.2009 për efekt të deklarimit periodik e vjetor, pasi ka qenë një marrëdhënie mirëbesimi mes motrës dhe vëllait. Kjo kontratë huaje është likuiduar nga viti 2009 deri në vitin 2015 në cash me burim të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes”*.

2.20. Në lidhje me të ardhurat e huadhënësit, subjekti ka deklaruar se: *“Vëllai i bashkëshortes Sh. M. është pronar i një biznesi, konkretisht “****” në bulevardin “****”, duke bashkëlidhur certifikatën e regjistrimit të QKR-së.*

2.21. Referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe dokumentacionit të depozituar në lidhje me aktivitetin privat të vëllait të bashkëshortes, rezulton se subjekti tregtar “Sh. M.”, person fizik, është regjistruar për ushtrim aktiviteti “****” me NIPT *** në datën 14.4.2009, pra, pas datës 14.1.2009, në të cilën subjekti ka pretenduar që i ka marrë hua shumën 1.700.000 lekë.

2.22. ISSH-ja, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.4.2023, ka përcjellë informacion për shtetasin Sh. M., i cili fillon pas muajit janar 2012, ndërsa Drejtoria Qendrore e Arkivit, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.4.2022, nuk ka konfirmuar të dhëna për periudha kontributive apo paga mbi të cilat ky subjekt është siguruar.

2.23. Edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3, në lidhje me huan e dhënë nga shtetasi Sh. M., subjekti ka deklaruar se ajo është marrë në fillim të muajit janar 2009. Në vlerësim të faktit se subjekti i rivlerësimi dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e huadhënësit kanë konfirmuar këtë marrëdhënie, referuar pikës 4 të nenit 32 të ligjit

nr. 84/2016, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, likuiditet dhëna hua.

2.24. Komisioni vlerëson se mbetet i paprovuar burimi i të ardhurave të huadhënësit Sh. M. për dhënien e huas, pretenduar në datën 14.1.2009. Megjithatë, nga Komisioni u krye analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2009 – 14.1.2009 për evidentimin e mundësisë financiare të subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes) nga burime të dokumentuara të të ardhurave, për pagesën e çmimit të apartamentit në Pogradec dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për periudhën dhe rezultoi me një balancë negative fondesh prej - 1.843.058 lekësh.

2.25. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

- Subjekti dhe personi i lidhur, bashkëshortja e tij, nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.1.2009, për porositjen e apartamentit me sip. 68 m² në qytetin e Pogradecit, Lagjja Nr. ***, rruga “***”.

- Subjekti dhe personi i lidhur nuk e kanë deklaruar këtë pasuri nga viti 2009 e në vijimësi, duke shkelur detyrimin ligjor të përcaktuar nga neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

- Personi i lidhur, bashkëshortja, ka lidhur kontratën e sipërmarrjes në datën 14.1.2009 dhe sipas së cilës ajo ka paguar shumën 1.890.000 lekë ditën e nënshkrimit, në datën 14.1.2009, referuar edhe mandatarkëtimit të shoqërisë “****” sh.p.k., ndërsa huaja e marrë nga vëllai i saj mban datën 18.11.2009. Aktiviteti i vëllait huadhënës është regjistruar në datën 14.4.2009 dhe huaja e dhënë nuk ka shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie.

- Subjekti dhe personi i lidhur nuk e kanë deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2016, vit në të cilin lidhën kontratën e shitblerjes me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Pogradec në emër të bashkëshortes së subjektit.

- Subjekti dhe personi tjetër i lidhur, huadhënësi Sh. M., nuk disponojnë dokumentacion justifikues financiar për burimin e krijimit të shumës 1.700.000 lekë në vitin 2009, shumë e cila është përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 68 m², në Pogradec. Gjatë hetimit rezultoi se huadhënësi ishte regjistruar në organin tatimor në një kohë më të vonshme se koha kur ai i kishte dhënë huan huamarrëses P. V.

- Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të justifikojnë me burime të ligjshme blerjen në datën 14.1.2009 të pasurisë, apartament me sip. 68 m², në Pogradec, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2009 – 14.1.2009 (balanca negative -1.843.058 lekë).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.26. Subjekti pas kalimit të barrës së provës deklaroi se: “Nga ana e bashkëshortes është deklaruar kontrata e huas në deklaratën e vitit 2009 dhe e ka përshkruar edhe qëllimin e marrjes së kësaj huaje, si dhe kohën e shlyerjes së saj. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën Vetting, si dhe në DPV 2017, atëherë kur është bërë kontrata e shitblerjes (kur është nënshkruar kontrata e shitblerjes (3.10.2016), kur jemi bërë pronarë të apartamentit, pra kur e kanë disponuar pronën. Bashkëshortja ka deklaruar rregullisht çdo vit me radhë, lidhur me shlyerjen e kësaj huaje sipas, rastit konkretisht 300.000 leke në vitin 2010, 400.000 lekë në 2011, 300.000 lekë në vitin 2012, 200.000 lekë në vitin 2013, 100.000 lekë në vitin 2014, dhe 400.000 lekë në vitin 2015, kur është likuiduar në total gjithë shuma e kësaj huamarrjeje.

*Lidhur me konstatimin se shtetasi Sh. M. nuk disponon dokumentacion provues justifikues financiar për burimin e krijimit të shumës 1.700.000 lekë në vitin 2009, e kam sqaruar në pyetësorë se shtetasi në fjalë ka aktivitet biznesi dhe është pronar i “***”, me adresë Bulevardi ***, pranë Ministrisë së Drejtësisë, që nga viti 2009. Më parë, ai ka qenë emigrant në Evropë dhe në vitin 2009 ka ardhur në Shqipëri dhe ka hapur këtë biznes, që vazhdon edhe aktualisht”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.27. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e përfaqësuesit ligjor në seancën dëgjimore, arsyeton se:

2.28. Referuar pikës 1 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016, në kuptim të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, kjo pasuri, sipas kuptimit të dhënë në pikën 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *Vetting*, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa dallim e kufizim.

2.29. Neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, detyron subjektet të deklarojnë pasuritë e paluajtshme dhe të drejta reale mbi to.

2.30. Në lidhje me burimin e kësaj pasurie, Komisioni vlerëson se vetëm fakti që një burim marrëdhënieje juridike huaje është deklaruar në deklaratat periodike dhe në dokumente zyrtare, të cilat në themel bazohen në thënie të palëve, nuk nënkupton automatikisht ekzistencën e burimit në sasinë apo rrethanat e deklaruar.

2.31. Subjekti ka treguar kujdes të deklarojë një burim të caktuar, pavarësisht nga mungesa e dokumentacionit të plotë shoqërues-provues, që duhet të përmbushë kriteret e kërkuara nga ligji lidhur me ligjshmërinë në formë dhe përmbajtje.

2.32. Lidhur me huan nga vëllai i bashkëshortes, trupi gjykues, pasi analizoi provat e administruara, konstatoi se burimi i huas i deklaruar nga subjekti nga aktiviteti i biznesit nuk mbështetej në prova dhe fakte, pasi regjistrimi i biznesit të vëllait është disa muaj pasi është kryer pagesa e plotë e çmimit të apartamentit.

2.33. Trupi gjykues vlerëson se mbështetur në përcaktimet e pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 19 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua, duke mos u dokumentuar mundësia financiare e personit tjetër të lidhur për dhënien e huas.

2.34. Sa më sipër, të ardhurat e dhëna hua, përdorur si burim për pasurinë bazuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nuk u provuan se janë të ardhura të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, ndaj dhe huaja në shumën 1.700.000 lekë, deklaruar e marrë nga shtetasi Sh. M. në datën 14.1.2009, nuk u përfshi në analizën financiare.

2.35. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme (balanca negative -1.843.058 lekë) për të justifikuar pasurinë e llojit apartament me sip. 68 m², në qytetin e Pogradecit, sipas parashikimeve të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

3. Garazh me sipërfaqe 17.36 m², rruga “**”, Tiranë, vlera 1.664.824 lekë**

3.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Garazh me sipërfaqe 17.36 m², rruga “***”, Tiranë, blerë më 18.4.2015 (marrë hua për blerjen e këtij garazhi 1.600.000 lekë më 8.4.2015), sipas kontratës nr. *** rep., vlera 1.664.824 lekë”.

3.2. Tek detyrimet financiare ndaj personave juridikë subjekti ka deklaruar: “Huamarrje për blerje garazhi 1.600.000 lekë, data e fillimit 8.4.2015, data e mbarimit 7.4.2021, me afat 6-vjeçar, pa interes. Kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.4.2015”.

3.3. Tek të dhënat konfidenciale të deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “huadhënës A. A. P., lindur në Fier dhe banues në Minnesota, SHBA. Burimi i huas: të ardhurat nga biznesi i tij në emigrim”.

3.4. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti në ndryshimet e pasurisë ka deklaruar: “Garazh me sipërfaqe 17.36 m², rruga “***”, Tiranë. Vlera e garazhit: 1.664.824 lekë. Burimi i krijimit të kësaj pasurie sipas kontratës së huas me nr. ***, datë 8.4.2015, në shumën 1.600.000 lekë”. Në formularin e detyrimeve financiare, në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Hua financiare për blerjen e një garazhi me sipërfaqe 17,36 m². Marrë shtetasit A. P. shuma prej 1.600.000 lekë në datën 8.4.2015 me afat deri në datën 7.4.2021, nr. kontrate huaje *** rep., *** kol.”.

3.5. Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme (garazh), me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2015, blerësi Perparim Vukaj blen nga shitësit I. dhe I. B. garazhin me sip. 17.36 m² në vlerën 1.664.824 lekë, vlerë e likuiduar në llogarinë e noterit.

3.6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2021, konfirmon se në emër të z. Perparim Vukaj figuron e regjistruar pasuria garazh me sip. 17.36 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***. Bashkëlidhur kartelë pasurie në emër të z. Perparim Vukaj. Shuma e paguar: 1.664.824 lekë.

3.7. Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti interesi me shitësit e kësaj pasurie. Me shkresën nr. *** prot., datë 5.4.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, informohet se nga verifikimi në indekset e kallëzimeve dhe statistikave e procedimeve penale, për periudhën kohore vitet 2013 – 2015, nuk rezultoi që ndaj këtyre shtetasve të jenë regjistruar kallëzime apo procedime në ngarkim, të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.

Analizë e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, si dhe mundësia financiare

3.8. Subjekti i rivlerësimit si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në deklaratën e interesave private për vitin 2015, ka deklaruar si burim për blerjen e kësaj pasurie një hua të marrë nga shtetasi A. P.

3.9. Me kontratë huaje të datës 8.4.2015, huadhënësi A. P. i ka dhënë subjektit të rivlerësimit shumën monetare në vlerën 1.600.000 lekë (të siguruar nga të ardhurat e kursimeve të veta dhe familjes së tij jashtë shtetit). Huaja është marrë jashtë zyrës noteriale dhe për nevoja familjare. Palët deklarojnë se kanë rënë dakord që afati i kësaj huaje të jetë 6 vjet, duke nisur nga data e nënshkrimit.

3.10. Bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 shtetasi A. P. është person tjetër i lidhur me subjektin dhe, si i tillë, duhet të verifikohet ligjshmëria e burimeve të krijimit të kësaj huaje në vlerën 1.600.000 lekë, shërbyer për blerjen e këtij garazhi nga ana e subjektit.

3.11. Subjekti nuk i ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor provues deklaratës *Vetting* që të vërtetojë burimin e ligjshëm.

3.12. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar ndër të tjera se: “...Kjo pasuri është blerë në datën 18.4.2015, çmimi i blerjes së kësaj pasurie është bërë nëpërmjet numrit të llogarisë së noterit pranë bankës BKT. Në datën 8.4.2015 është marrë huaja në shumën 1.600.000 lekë shtetasit A. A. P., me të cilin kemi miqësi familjare dhe është banues në

Minnesota, Amerikë. Mënyra e dhënies së kësaj huaje ka qenë në cash. Shtetasi A. P. ndodhet në Amerikë që prej vitit 1997, i cili ka biznesin e tij në Minnesota”.

3.13. Në përgjigje të këtij pyetësori është bashkëlidhur nga subjekti edhe dokumentacion për përfitimin dhe shlyerjen e kësaj huaje, por në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit Komisioni konstatoi se nga subjekti i rivlerësimit nuk u dokumentua koha dhe mënyra e transferimit të këtyre likuiditeteve nga SHBA-ja, si dhe burimi i të ardhurave të deklaruara të huadhënësit për dhënien e huas në datën 8.4.2015, për rrjedhojë të mos përfshijë shumën e marrë hua në analizën paraprake financiare.

3.14. Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 – 18.4.2015, për evidentimin e mundësisë financiare të subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes) nga burime të dokumentuara të të ardhurave, për pagesën e çmimit të blerjes së garazhit me sip.17.36 m², si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për periudhën e sipërcituar, duke rezultuar me një balancë negative prej -1.396.860 lekësh.

3.15. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se: (i) nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk u dokumentua koha dhe mënyra e transferimit të këtyre likuiditeteve nga SHBA-ja; (ii) burimi i të ardhurave të deklaruara të huadhënësit për dhënien e huas në datën 8.4.2015; (iii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të justifikojnë me burime të ligjshme blerjen në datën 18.4.2015 të pasurisë garazh me sip. 17.36 m² në Tiranë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

3.16. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka deklaruar se: *“Në përgjigje të pyetësorëve kam shpjeguar se kjo pasuri është blerë në datën 18.4.2015, çmimi i blerjes është paguar në numrin e llogarisë së noterit pranë BKT-së.*

Huaja në shumën 1.600.000 lekë është marrë në datën 8.4.2015 nga shtetasi A. P. Mënyra e dhënies së kësaj huaje ka qenë cash. Lidhur me konstatimin se nga subjekti i rivlerësimit nuk u dokumentua koha dhe mënyra e transferimit të këtyre likuiditeteve nga SHBA-ja, si dhe burimi i të ardhurave të deklaruara të huadhënësit, kam sqaruar dhe saktësuar burimin e krijimit të kësaj prone, të ardhurat e huadhënësit që janë të ardhura nga biznesi i tij në SHBA, ju dërgoj edhe të ardhurat neto për vitin 2014, 2015 dhe 2016 për të provuar dhe dokumentuar burimin e kësaj huaje.

Huadhënësi ka të ardhura neto për vitin 2014 73.300 USD, për vitin 2015 97.578 USD dhe për vitin 2016 182.823 USD. Pra, burimi i krijimit të kësaj pasurie është më se i ligjshëm dhe në përputhje me standardet e mbajtura nga Komisioni. Analiza paraprake financiare për periudhën 1.1.2015 – 18.4.2015 është marrë në kundërshtim me faktet, duke mos përfshirë huan, prandaj konkluzioni me balancë negative është i gabuar”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.17. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shpresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shpresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratën e përfaqësuesit ligjor në seancën dëgjimore, arsyeton se:

3.17.1. Në lidhje me mundësinë e huadhënësit A. P. në shumën 1.600.000 lekë në prill të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion deklaratën e tatimit mbi të ardhurat Individuale në SHBA për vitet 2014, 2015 dhe 2016. Në analizën financiare është përdorur

vetëm deklarata e tatimit mbi të ardhurat e vitit 2014. Nga i njëjti dokument vihet re se huadhënësi A. P. jetonte me 4 persona të tjerë në vitin 2014 (bashkëshortja, vajzat dhe mbesa).

3.17.2. Duke mbajtur në konsideratë edhe shpenzimet për jetesë me qira dhe/ose shpenzime të tjera të kryera nga ky shtetas në shtetin ku jeton apo në shtetin shqiptar, të dhënat e referuara dhe të rezultuara nga hetimi administrativ, nuk bindin trupin gjykues lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit për dhënien e kësaj huaje subjektit te rivlerësimit.

3.17.3. Komisioni vlerëson se këto të ardhura të deklaruara si të disponuara nga huadhënësi në SHBA nuk mund të shërbejnë për të provuar ekzistencën e burimit të ligjshëm të huas dhënë prej tij, pasi vërtetësia e thënieve nuk konstatohet e provuar dhe sepse nga analiza e të gjithë dinamikës dhe elementeve përbërëse të shtjelluara, në mënyrë kritike dhe në tërësi me gjithë elementet e tjera, çojnë Komisionin në dyshime për vërtetësinë e deklarimeve mbi marrëdhënien financiare të huas.

3.17.4. Trupi gjykues e gjen të paarsyeshëm edhe shpjegimin e dhënë nga subjekti, edhe rrjedhën e ngjarjeve, sipas të cilave vlerat monetare të fituara në SHBA u transportuan *cash* në Shqipëri për t'iu dhënë hua subjektit për blerjen e një garazhi. Nëse individë, shtetas amerikan, me banim në SHBA kishte vendosur të ndihmonte subjektin, mund ta bënte duke mundësuar këtë sasi të hollash nëpërmjet një transaksioni bankar apo dokumentacioni financiar provues, pasi fakti që palët e kanë kryer këtë transaksion *cash* në vlerë të konsiderueshme monetare nuk i krijon bindjen trupit gjykues mbi vetë vlefshmërinë e transaksionit.

3.17.5. Në lidhje me burimin edhe të kësaj pasurie, Komisioni vlerëson se vetëm fakti që një burim marrëdhënieje juridike huaje është deklaruar në deklaratat periodike edhe në dokumente zyrtare, të cilat në themel bazohen në thënie të palëve, nuk nënkupton automatikisht ekzistencën e burimit në sasinë apo rrethanat e deklaruara.

3.18. Sa më sipër, mbështetur në një vlerësim të arsyeshëm të të gjitha rrethanave, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit me barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ për huan e pretenduar.

3.19. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e llojit garazh sipas parashikimeve të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

3.20. Komisioni, në analizë të të gjitha fakteve, provave dhe shpjegimeve të subjektit gjatë hetimit, por edhe pas kalimit të barrës së provës, në lidhje me transaksionet e kryera nga subjekti me pasuritë e paluajtshme konstatoi veprime fiktive në nënshkrimin e disa kontratave të shitjes apo akteve noteriale pa qenë prezent pala, të cilat kishin si qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme të pasurive që do të krijonte subjekti në të ardhmen.

3.21. Në konkluzion në lidhje me transaksionet e kryera nga subjekti në lidhje me pasuritë e paluajtshme trupi gjykues, arsyetuar më sipër, arrin në konkluzionin se subjekti është përpjekur të krijojë burime të ligjshme për justifikimin e blerjeve të pasurive të paluajtshme.

3.22. Sa më sipër, subjekti ndodhet në situatën faktike të përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

4. Automjet tip “Mercedes-Benz”, shitur në vitin 2007 me çmim 650.000 lekë

4.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “Në vitin 2007 kam shitur një automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, në vlerën 650.000 lekë”.

4.2. Në deklaratën e interesave private të vitit 2007 subjekti ka deklaruar: “Shitur një autoveturë tip “Mercedes-Benz” datë 6.7.2007, me nr. kontrate ***, shtetasit N. G. C., Korçë, me vlerë 650.000 lekë”.

4.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me çmimin e shitjes së automjetit më shumë se dyfishi i çmimit të blerjes pas përdorimit prej 1 viti subjekti deklaroi se: *“Kjo makinë është blerë me defekt teknik, i cili është riparuar dhe më pas është shitur sipas kontratës”*. Pyetësorit nuk i ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor provues për rregullimin e defekteve të mjetit.

4.4. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2023, vë në dispozicion të Komisionit dosjen e këtij automjeti. Me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2007 shitësi Perparim D. Vukaj i shet blerësit N. G. C. automjetin tip “Mercedes-Benz”, ngjyrë kafe, kundrejt çmimit prej 200.000 lekësh, shumë e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

4.4.1 Gjithashtu, DPSHTRR-ja i ka bashkëlidhur dosjes edhe kontratën e blerjes së këtij automjeti nga subjekti: kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.11.2006, ku z. Perparim Vukaj blen nga shitësi A. G. automjetin me targë ***, prodhim i vitit 1990, në shumën 300.000 lekë.

4.5. Komisioni konstatoi se kontrata e paraqitur nga subjekti me deklaratën *Vetting* ka të njëjtët numra repertori dhe koleksioni dhe datë me kontratën që ndodhet në dosjen e automjetit pranë DPSHTRR-së, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2007, hartuar nga e njëjta noterë, znj. F. B., anëtare e Dhomës së Notereve ***, vetëm çmimi ndryshon. Tek kontrata e depozituar nga subjekti çmimi është 650.000 lekë, ndërsa tek kontrata që ndodhet në dosjen e DPSHTRR-së kontrata ka çmimin 200.000 lekë.

4.6. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

- Subjekti ka kryer deklaram të rremë në deklaratën *Vetting* në lidhje me çmimin e shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë ***.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.7. Subjekti pas kalimit të barrës së provës ka deklaruar se: *“Në lidhje me këtë konstatim kam shpjeguar se automjetin tip “Mercedes-Benz” me targë *** e kam blerë me kontratë noteriale shitblerjeje nr. ***, datë 25.11.2006, nga shitësi, shtetasi A. G., në shumën 300.000 lekë. Këtë autoveturë e kam deklaruar se ia kam shitur shtetasit N. C. sipas kontratës nr. ***, datë 6.7.2007, në vlerën 650.000 lekë. Këtë fakt e kam deklaruar edhe në deklaratën e vitit 2007 edhe në deklaratën *Vetting*”*.

Arsyeja e diferencës së çmimit të shitjes me atë të blerjes ka qenë fakti se automjetin e ka blerë me defekt dhe e ka shitur të riparuar. Gjykuar nga koha (viti 2007) nuk ka pasur servise të formalizuara me fatura tatimore, prandaj nuk është bërë e mundur që Komisionit t'i ofrohen fakte apo prova të riparimit të këtij automjeti.

*Fakti që në dosjen e paraqitur nga blerësi, shtetasi N. C., pranë DPSHTRR-së, kjo kontratë ka çmim tjetër, nuk ka të bëjë me subjektin apo me deklaramet e tij. Subjekti ka shitur automjetin dhe ka marrë një kopje të aktit të shitjes dhe e ka deklaruar konform ligjit si në DPV-në e vitit 2007, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*”*.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.8. Në analizë të të gjitha rrethanave të përmendura sa më sipër, trupi gjykues vëren se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerën e automjetit është ai i kryer në deklaratën *Vetting*, në rubrikën përkatëse ku deklarohen vlerat e pasurisë. Në këtë rubrikë, subjekti ka deklaruar si vlerë të kësaj pasurie shumën 650.000 lekë.

4.9. Për efekt të procesit të rivlerësimit, ky deklarim i është nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tij në zbatim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, çdo vlerë tjetër e deklaruar për këtë pasuri duhet të shërbejë për të konfirmuar ose jo vërtetësinë e këtij deklarimi të kryer në deklaratën e pasurisë *Vetting*.

4.10. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni, i cili ka konstatuar se subjekti në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007 ka deklaruar vlerën e këtij automjeti në shumën 650.000 lekë.

4.11. Komisioni, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar informacion me qëllim verifikimin e deklarimeve të subjektit nga DPSHTRR-ja, e cila ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen përkatëse të automjetit. Sipas këtij dokumentacioni, ka rezultuar se vlera e automjetit nuk ishte ajo e deklaruar nga subjekti, por një vlerë tri herë më e vogël.

4.12. Rritja e çmimit të shitjes së automjetit me më shumë se trefishin e çmimit real, është një përpjekje e subjektit për të krijuar gjendje likuiditeti, që do të shërbenin në të ardhmen për krijimin e pasurive të tjera.

4.13. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit arrin në konkluzionin se subjekti ka kryer deklarim të rremë në lidhje me deklarimin e vlerës së shitjes së automjetit, duke u ndodhur në situatën, e cila kualifikohet, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.

5. Automjet tip “Toyota”, blerë në vitin 2008, me vlerë 3.500 euro

5.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip “Toyota”, me targë ***, prodhim i vitit 2001, blerë në vitin 2008, në vlerën 3.500 euro*”.

5.2. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008 subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip “Toyota”, blerë më 28.1.2008, në shumën 3.500 euro*”.

5.3. DPSHTRR-ja, me shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.2.2021, ka konfirmuar se në emër të subjektit është i regjistruar automjeti me targë ***. Automjeti tip “Toyota Land Cruiser”, vit prodhimi 2001, ka qenë i regjistruar në emër të subjektit në datën 14.2.2008, me targë ***.

5.4. Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.1.2008, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi A. Xh. automjetin tip “Toyota” në çmimin 3.500 euro (kontratës i bashkëlidhet edhe leja e qarkullimit të mjetit).

5.5. Referuar të dhënave nga dega e doganës Korçë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.5.2023, rezulton se ky automjet është zhdoganuar me DAV ***.***, datë 30.1.2008, dhe janë paguar detyrimet doganore në shumën 361.601 lekë me mandatin nr. ***, datë 30.1.2008, nga subjekti i rivlerësimit.

Analizë e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, si dhe mundësia financiare

5.6. Në deklarim të interesave periodikë privatë për vitin 2008 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar burim të të ardhurave për blerjen e këtij automjeti.

5.7. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër të tjera se: “*...Të ardhurat për blerjen e automjetit tip “Toyota” në vitin 2008, kanë qenë nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” në vitin 2007, fakt të cilin e kam deklaruar edhe në deklaratimet periodike vjetore si në vitin 2007, dhe në vitin 2008, si dhe në shpjegimet e dhëna me datën 5.2.2016 në zyrën e Inspektorit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive*”.

5.8. Referuar deklarimeve të interesave privatë periodikë të vitit 2007, subjekti ka deklaruar shitje të automjetit tip “Mercedes-Benz” në datën 6.7.2007, për të cilin nga Komisioni u vlerësua të merrej në konsideratë si e ardhur nga shitja shuma 200.000 lekë. Subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditeti *cash* në fund të vitit 2007, por edhe nëse do të merret në konsideratë pretendimi që të ardhurat nga shitja e automjetit kanë qenë gjendje *cash* në fund të vitit, përsëri ky burim ka qenë i pamjaftueshëm për blerjen e automjetit tip “Toyota” në datën 28.1.2008.

5.9. Nga Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar, u krye analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2008 – 30.1.2008 për evidentimin e mundësisë

financiare të subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes), nga burime të dokumentuara dhe të deklaruara të të ardhurave, për pagesën e çmimit të blerjes së automjetit në vlerën 3.500 euro, në datën 28.1.2008, pagesën e shpenzimeve të zhdoganimit në shumën 361.601 lekë, në datën 30.1.2008, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për periudhën e sipërcituar, duke rezultuar me një balancë negative prej -721.125 lekësh.

5.10. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit për sa duket se:

- Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të justifikojnë me burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “Toyota” në datën 28.1.2008, pagesën e detyrimeve doganore në datën 30.1.2008, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2008 – 30.1.2008 (balanca negative -721.125 lekë).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.11. Subjekti pas kalimit të barrës së provës ka deklaruar se: *“Sqaroj se kjo analizë e treguesve financiarë është totalisht e gabuar, pasi nuk më është llogaritur asgjë nga kursimet e një viti më parë, konkretisht të vitit 2007 dhe as nga të ardhurat e fillimvitit 2008.*

Të ardhurat nga paga si prokuror në vitin 2007 janë: 1.546.000 lekë, të ardhura nga paga e bashkëshortes 960.000 lekë, si mësuese në Pogradec. Dhuratë nga motra në shumën 4.500 euro.

Të ardhurat gjatë vitit 2007 kanë qenë mbi 3.000.000 lekë dhe jo të merret gjendja 0, pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar gjendje, kursime në fund të vitit 2007, pasi nuk ka qenë i qartë plotësimi i deklaratës. Për sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë pikë se subjekti ka qenë në balancë të fondeve negative për të krijuar këtë pasuri në muajin e parë të vitit 2007, nuk qëndrojnë”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.12. Në analizë të rrethanave dhe fakteve, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti në DIPP-të e viteve 2003 – 2007 nuk ka deklaruar gjendje, shtesa/pakësime të kursimeve *cash*. Bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ka pasur detyrim deklarimin e tyre në DIPPV-në përkatëse.

5.13. Neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar “Afati dhe objekti i deklarimit”, parashikon se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil; dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”.*

5.14. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, subjekti, në përgjigje të pyetjes nr. 12, ka deklaruar se: *“...Kursimet e mia ndër vite i kam depozituar në sistemin bankar...”.*

5.15. Pretendimi i subjektit se ka pasur gjendje likuiditeti nga të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe nga dhurata e motrës, nuk çojnë në përfundimin se këto të ardhura kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti në datën 28.1.2008 dhe pagimin e shpenzimeve të zhdoganimit. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, nuk u provua që subjekti ka disponuar kursime *cash*.

5.16. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008 dhe në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burim për këtë pasuri. Në pyetësorin nr. 3, si burim për këtë pasuri subjekti deklaroi

se të ardhurat për blerjen e këtij automjeti janë nga shitja e automjetit tjetër tip “Mercedes-Benz” në vitin 2007.

5.17. Edhe sikur Komisioni t’i përmbahet këtij burimi të ardhurash të deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit, ato nuk mjaftojnë, pasi, siç rezultoi nga hetimi, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” ishin 200.000 lekë dhe jo 650.000 lekë sa ishin deklaruar nga subjekti.

5.18. Në përfundim, trupi gjykues, nga sa analizuar më sipër, bazuar në rrethanat dhe faktet e disponuara, arsyeton se subjekti ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

6. Depozita bankare në Intesa Sanpaolo Bank në emër të vajzës dhe djalit në vlerë përkatësisht nga 11.674,59 euro secili

6.1. Personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) i ka deklaruar në deklaratën *Vetting* këto depozita bankare, duke shpjeguar se vlera e deklaruar ka përfshirë edhe interesat në vite, të ardhurat janë depozituar nga viti 2007 deri në vitin 2012, me burim të ardhura nga të afërmit e familjes në emigracion dhe kursimet familjare në vite.

6.2. Në deklaratën e interesave periodikë privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë për llogari kursime *“fonde për të ardhmen e fëmijëve”* në Bankën Amerikane, në emër të vajzës dhe djalit me nga 5.000 euro, depozituar në datën 24.4.2007”.

6.3. Në DIPP-të e viteve 2008 – 2016, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar ecurinë e këtyre llogarive depozitë në emër të fëmijëve, shtesat në këto llogari dhe burimin e të ardhurave për krijimin e tyre.

6.4. Referuar të dhënave nga Intesa Sanpaolo Bank, rezulton se bashkëshortja ka depozituar *cash* në datën 26.12.2006 shumën 10.000 USD dhe në datën 23.3.2007, ka tërhequr *cash* shumën 9.900 USD.

6.5. Në llogaritë në euro në emër të vajzës dhe djalit në Intesa Sanpaolo Bank, është depozituar në datën 24.4.2007 shuma 5.000 euro për secilin, e cila ka qenë në depozitë me afat, periodikisht duke u shtuar me interesa, gjithashtu në datën 2.3.2012 është depozituar *cash* shuma prej 2.000 euro në llogari të secilit prej fëmijëve nga bashkëshortja e subjektit dhe në datën 2.11.2012 është shtuar me shumën 3.000 euro për çdo llogari të fëmijëve nga nëna e subjektit. Gjendja e këtyre llogarive në fund të vitit 2016 rezulton në shumën 11.674.59 euro për secilin prej fëmijëve.

6.6. Në përgjigje të procesverbalit të datës 25.1.2016, në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër të tjera se: “...*Kjo depozitë në vitin 2007 është tërhequr dhe ka kaluar në llogaritë futura të të dy fëmijëve, në shumën 5.000 USD/secila, llogari të deklaruar nga ana ime. Duke qenë se derdhja nga bashkëshortja është kryer më 26.12.2006, pra, në fund të vitit nuk është deklaruar në deklaratën e vitit 2006, duke e llogaritur si veprim të ndodhur në vitin 2007...*”.

6.7. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar në procesverbalin e datës 5.2.2016 në ILDKPKI se: “*Shtesat në të dyja llogaritë e kursimeve në Intesa Sanpaolo Bank, në emër të L. dhe M. V., për vitin 2012 janë derdhur nga bashkëshortja në shumën 2.000 euro për secilën llogari, me burim të ardhurat nga kurset private për pushimet verore të bashkëshortes. Nuk janë deklaruar të ardhurat nga kurset private të bashkëshortes, duke menduar se janë derdhur në bankë dhe janë lehtësisht të verifikueshme. Ndërsa diferenca e shtesës prej 3.000 euro në vitin 2012 në të dyja llogaritë e kursimeve të fëmijëve në Intesa Sanpaolo Bank në emër të fëmijëve janë kontribut i nënës sime. Si burim janë kursimet e nënës të krijuara nga të ardhurat nga fëmijët e saj emigrantë në Zvicër, Itali dhe Holandë. Duke qenë se nëna jeton me mua, ka kryer derdhjet si kontribut për të dy fëmijët e mi, pa dijeninë time*”.

6.8. Referuar deklarimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit bankar të administruar, Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar:

- në DIPPV-në e vitit 2006, depozitim/gjendjen në datën 31.12.2006 të shumës 10.000 USD pranë Intesa Sanpaolo Bank, në emër të bashkëshortes, si dhe burimin e të ardhurave për krijimin e saj;

- në DIPP-në e vitit 2012, depozitimet e bëra nga bashkëshortja, depozitimet/dhurimet e bëra nga nëna e tij, dhe burimin e të ardhurave për shumat shtuar në këto llogari bankare në këtë vit.

Analizë e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, si dhe mundësia financiare

6.9. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit si burim për krijimin e këtyre vlerave monetare depozitë ka deklaruar: *“Të ardhura nga të afërmit e familjes në emigracion dhe kursimet familjare në vite”*.

6.10. Nisur nga fakti që në deklarimin e interesave privatë për vitin 2007 nuk është deklaruar burimi i të ardhurave për krijimin e shumës prej 5.000 euro në secilën prej dy llogarive depozitë në emër të fëmijëve në Intesa Sanpaolo Bank, Komisioni vlerësoi të marrë në konsideratë burimin e deklaruar nga subjekti në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 25.1.2016, në të cilin ka përcaktuar depozitën në emër të bashkëshortes në dollarë në Intesa Sanpaolo Bank, e cila është hapur në datën 26.12.2006, si burim për krijimin e depozitave të fëmijëve në këtë bankë.

i) Nga Komisioni u analizua burimi i krijimit të shumës prej 10.000 USD të depozituar në datën 26.12.2006, në llogarinë në emër të bashkëshortes në Intesa Sanpaolo Bank

6.11. Subjekti në DIPP-në e vitit 2006, subjekti nuk e ka deklaruar këtë depozitë dhe as burimin e krijimit të saj. Në këtë vit është deklaruar blerja e një automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, në vlerën 300.000 lekë (pa deklaruar burim të të ardhurave), ndërsa në DIPPV-në e vitit 2005 në seksionin “Të dhëna konfidenciale” janë deklaruar, ndër të tjera, edhe *“dhuruar nga vëllai emigrant në Holandë T. V. shuma 5.000 euro në datën 14.3.2006”*

6.12. Në lidhje me këto dhurime nga vëllai subjekti, në përgjigje të ILDKPKI-së, ka deklaruar se: *“Këto dhurata janë sjellë për prindërit, duke qenë se kanë jetuar me mua i kam administruar unë...”*. Komisioni ka vlerësuar se destinacioni i deklaruar i tyre nuk ka qenë i lidhur me krijim të pasurive apo mbulim të shpenzimeve nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

6.13. Ndërsa për sa i përket kursimeve *cash* në banesë, nga subjekti referuar deklarimeve të viteve 2003 – 2005, nuk është deklaruar ndonjë kursim gjendje dhe/ose shtesë, pakësim.

6.14. Nga Komisioni, sa më sipër është vlerësuar që në analizën paraprake financiare për mundësinë e krijimit të kësaj depozite më 26.12.2006, në vlerën 10.000 USD, të mos përfshihet shuma 5.000 euro, e deklaruar si e dhuruar nga vëllai në datën 14.3.2006 (pasi ka pasur tjetër destinacion të deklaruar), por si të ardhura të merren në konsideratë vetëm të ardhurat e dokumentuara nga paga² për periudhën 1.1.2006 – 26.12.2006. Pjesë e kësaj analize janë edhe blerja e automjetit në datën 25.11.2006, në vlerën 300.000 lekë, si dhe shpenzimet e deklaruara dhe evidentuara për këtë periudhë.

6.15. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të deklaruara dhe të dokumentuara të të ardhurave për krijim të pasurive (përfshirë edhe depozitën në datën 26.12.2006, në dollarë, në emër të personit të lidhur në Intesa Sanpaolo Bank), si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2006 – 26.12.2006 (balanca

² Sa i takon dietave të përfituara, trupi gjykues mban në konsideratë vendimmarrje të Kolegjit dhe rithekson se dietat janë vlera monetare të ofruara punonjësve/funksionarëve me qëllim përballimin/rimbursimin e shpenzimeve të shtuara, në kuadër të lëvizjeve jashtë qendrës së tyre të punës, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre dhe, në këtë kuadër dhe për sa kohë nuk provohet se dieta nuk është shpenzuar për qëllimin për të cilin është dhënë, por ajo është kursyer, nuk mund të llogaritet si e ardhur (te rubrika “Të ardhura/të hyra”) në ekonominë familjare të subjektit të rivlerësimit, për efekt të analizës së të ardhurave dhe shpenzimeve... Referuar jurisprudencës së Kolegjit, vendimi nr. 27/2019.

negative -469.253 lekë), për rrjedhojë edhe llogaritë depozitë në emër të fëmijëve të krijuara në vitin 2007 në shumën 5.000 euro për secilin, për të cilat është pretenduar burim, llogaria e sipërcituar e bashkëshortes në dollarë në të njëjtën bankë, duket se ka qenë me pamjaftueshmëri të burimit të krijimit.

ii) Nga Komisioni u analizua ecuria dhe burimi i krijimit të shtesave të depozitave në emër të fëmijëve në Intesa Sanpaolo Bank në vitin 2012

6.16.Referuar edhe pasqyrimin të bërë më lart, në sqarimet e dhëna nga subjekti në procesverbalin e datës 5.2.2016 në ILDKPKI, ashtu edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me shtesat në llogaritë e fëmijëve në vitin 2012, përkatësisht:*Depozitimi në Intesa Sanpaolo Bank nga bashkëshortja në datën 2.3.2012, në shumën 2.000 euro, për secilin nga fëmijët, në total 4.000 euro.* Subjekti ka pretenduar si burim për këto vlera monetare: *“Të ardhurat nga kurset private për pushimet verore të bashkëshortes”*.

6.17.Në deklaratën *Vetting*, në seksionin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike”, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar edhe të ardhura të krijuara nga veprimtari private (kurse mësimi) në vitet 2009 – 2012 në shumën 4.000 euro, këto të ardhura janë depozituar në llogarinë bankare të fëmijëve.

6.18.Komisioni konstaton se subjekti, përveçse nuk ka deklaruar shtesën në depozitë në vitin 2012, të ardhurat e pretenduara për periudhën 2009 – 2012, gjendjet *cash* të shtuara/pakësuara në këto vite, nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të vërtetuar të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij, duke dhënë kurse private në shumën 4.000 euro.

6.19.Komisioni ka kërkuar informacion në lidhje me të ardhurat e deklaruara/përfituara nga shtetasja P. N. V. nga ushtrimi i aktivitetit në fushën e mësimdhënies dhe/ose të ardhurat e tjera personale për periudhën 2009 – 2012, dhe pagesat e tatimit përkatës mbi këto të ardhura.

6.20.Drejtorja Rajonale Tatimore Korçë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.4.2023, informon se shtetasja P. V., mbështetur në të dhënat e sistemit informatik, rezultoi punësuar pranë Drejtorisë Arsimore Qytet Tiranë, por nuk ka dhënë asnjë informacion në lidhje me ushtrimin e aktivitetit në fushën e mësimdhënies dhe/ose të ardhurat e tjera personale nga personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit).

6.21.Në pyetësorin nr. 3, në lidhje me të ardhurat e krijuara nga veprimtaria private e bashkëshortes, kurse mësimi në vitet 2009 – 2012, të cilat janë depozituar në llogarinë bankare të fëmijëve, subjekti deklaroi se: *“Ne nuk kemi deklaruar të ardhura nga aktiviteti biznesi për bashkëshorten, pasi nuk është e regjistruar në organet tatimore për ndonjë aktivitet privat, kurset e zhvilluara kryesisht gjatë pushimeve verore janë kryer në banesat e fëmijëve”*.

6.22.Mbështetur në sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të dokumentojë ushtrimin e aktivitetit/kurseve nga ana e personit të lidhur, shumën e përfituar, kohën e përfitimit, si dhe pagesën e detyrimeve përkatëse tatimore për të ardhurat e pretenduara, si burim për shumën në total prej 4.000 euro, të depozituar nga bashkëshortja e subjektit në llogari të fëmijëve në Intesa Sanpaolo Bank, në datën 2.3.2012.

6.23. Në lidhje me shtesat në llogaritë e fëmijëve përkatësisht:*Depozitimi në Intesa Sanpaolo Bank nga nëna e subjektit në datën 2.11.2012, në shumën 3.000 euro, për secilin nga fëmijët, në total 6.000 euro*

6.24.Në deklaratën *Vetting*, subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk kanë deklaruar dhurim nga nëna e subjektit, por bashkëlidhur deklaratës *Vetting* është depozituar deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2017, sipas së cilës znj. Z. V. deklaroi se: *“I kam depozituar nipit dhe mbesës përkatësisht nga 3.000 euro secilit në datën 2.11.2012, me burim të ardhurat e fëmijëve të mi T., Sh. dhe M. V. Duke qenë se unë jetoj me nipin dhe mbesën, kisha dëshirë që këto të ardhura që kisha kursyer t’ua depozitohet atyre”*.

6.25.Referuar deklaratës së interesave privatë periodikë të vitit 2012, subjekti ka deklaruar në përbërje familjare sipas certifikatës së gjendjes civile 4 persona, përfshirë deklaruesin, dhe nëna e tij nuk është pjesë e kësaj certifikate.

6.26.Subjekti në procesverbalin e ILDKPKI-së ka shpjeguar se: “...diferenca e shtesës prej 3.000 euro në vitin 2012 në të dyja llogaritë e kursimeve të fëmijëve në Intesa Sanpaolo Bank në emër të fëmijëve janë kontribut i nënës sime. Si burim janë kursimet e nënës të krijuara nga të ardhurat nga fëmijët e saj emigrantë në Zvicër, Itali dhe Holandë...”.

6.27.Në pyetësonin nr. 2, në lidhje me burimin e të ardhurave të nënës së tij, për shumat e depozituara cash në vlerën 6.000 euro, subjekti deklaroi se: “Depozita prej 6.000 euro nga nëna Zoje Vukaj janë kursimet e saj ndër vite³”.

6.28.Në bazë të vërtetimit datë 12.4.2023 të ISSH Drejtoria Rajonale Tiranë, rezultoi se znj. Z. V. (nëna e subjektit) trajtohet me pension pleqërie për periudhën 1.1.2003 – 2.11.2012 në vlerën 674.037 lekë.

6.29.Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për burimin e krijimit të shumës 6.000 euro nga znj. Z. V. (deklaruar nga fëmijët e saj në emigracion Zvicër dhe Itali), shumë e cila është depozituar në llogarinë e fëmijëve të subjektit në vitin 2012 (nga 3.000 euro secili).

6.30. Sa më sipër, duket se subjekti përveç sa nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 depozitimet/dhurimet e bëra nga nëna e tij, nuk ka arritur gjithashtu të dokumentojë burimin e të ardhurave të nënës për shtim të depozitave në emër të fëmijëve të tij në Intesa Sanpaolo Bank, në datën 2.11.2012. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar të mos pasqyrohet në analizë si e ardhur shuma e pretenduar dhuratë nga nëna e subjektit në vitin 2012.

6.31. Nga Komisioni u krye analiza paraprake financiare për vitin 2012, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për shtim të likuiditeteve bankare, si dhe kryerje të shpenzimeve të ndryshme për këtë vit, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën -939.951 lekë.

6.32. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit për sa duket se:

- Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar: (i) në DIPPV-në e vitit 2006, depozitim/gjendjen në datën 31.12.2006 të shumës 10.000 USD pranë Intesa Sanpaolo Bank, në emër të bashkëshortes, si dhe burimin e të ardhurave për krijimin e saj; (ii) në DIPP-në e vitit 2012, depozitimet e bëra nga bashkëshortja, depozitimet/dhurimet e bëra nga nëna e tij, si dhe burimin e të ardhurave për shumat e shtuara në këto llogari bankare në këtë vit.
- Nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor burimin e deklaruar të të ardhurave të bashkëshortes dhe të nënës së tij për shtim të depozitave në emër të fëmijëve të tij në Intesa Sanpaolo Bank në vitin 2012.
- Kanë qenë në pamundësi financiare për krijim të depozitës në emër të bashkëshortes në datën 26.12.2006.
- Kanë qenë në pamundësi financiare në vitin 2012, për shtim të depozitave në emër të fëmijëve në Intesa Sanpaolo Bank.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6.33. Subjekti pas kalimit të barrës së provës ka deklaruar se: “Jam përgjigjur në ILDKPKI me procesverbalin e datës 25.1.2016, në vitin 2004 vëllai ka sjellë 2.000 euro dhe në vitin 2005 ka sjellë 5.000 euro. Këto shuma kanë shërbyer për depozitën e vitit 2006. Arsytimi i Komisionit

³ Bashkëlidhur pyetësorit subjekti depoziton edhe deklaratën noteriale të znj. Z. V. datë 18.1.2017.

se këto shuma janë sjellë për prindërit dhe nuk mund të shërbenin për llogari bankare, është i gabuar.

Bashkëshortja nuk kishte asnjë mundësi regjistrimi në organet tatimore, pasi ajo ishte me kontratë pune pa afat, me kohë të plotë, në shkollën “****” dhe paguhej për gjithë vitin. Ishte i pamundur regjistrimi si aktivitet privat, prandaj kurset i ka ushtruar në mënyrë informale.

Lidhur me depozitimin me datë 2.11.2012 të nënës të shumave nga 3.000 euro dy fëmijëve të mi, kam deklaruar në deklaratën Vetting dhurim nga nëna, duke bashkëlidhur një deklaratë noteriale të nënës, sipas së cilës ajo deklaroi se: “I kam depozituar nipit dhe mbesës nga 3.000 euro, në datën 2.11.2012, me burim të ardhurat e fëmijëve T., Sh. dhe M. V.. Duke qenë se unë jetoj me nipin e mbesën, kisha dëshirë që këto të ardhura që kisha kursyer t’ua depozitoja atyre”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6.34. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

6.35. Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, në nenin 4 parashikon se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil; dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”. Ky detyrim ligjor nuk është respektuar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja e tij, të cilët nuk deklaruan në DIPPV-në e vitit 2006 depozitën në shumën 10.000 USD.

6.36. Në lidhje me depozitimet e bëra në vitin 2012 nga bashkëshortja e subjektit në llogaritë e fëmijëve në shumat 2.000 euro secili, trupi gjykues i Komisionit arsyeton se:

6.37. Vlerësimi i shtesave në llogaritë bankare të fëmijëve me të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit nga kurset private do të bëhet bazuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

6.38. Pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës përcakton se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.

6.39. Në pyetësin nr. 3, subjekti deklaroi se nuk ka të ardhura nga aktiviteti i biznesit për bashkëshorten, pasi nuk është regjistruar në organet tatimore për aktivitet privat. Kurset e zhvilluara gjatë pushimeve verore janë kryer në banesat e fëmijëve.

6.40. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk u provua koha kur ishin realizuar këto të ardhura, shuma e tyre dhe pagesa e detyrimeve tatimore.

6.41. Në aplikim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues nuk përfshiu në analizën financiare shtimet në llogarinë e fëmijëve nga bashkëshortja e subjektit, pasi ishin të ardhura që nuk kënaqnin kërkesat e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ato ishin të ardhura për të cilat nuk ishin paguar detyrimet tatimore, pra nuk ishin të ardhura të ligjshme në kuptim të dispozitës kushtetuese.

6.42. Në lidhje me depozitimet e bëra nga nëna e subjektit në llogaritë bankare të fëmijëve në shumën 3.000 euro secili, trupi gjykues konstatoi se gjatë hetimit administrativ subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të nënës.

6.43. Pretendimet e subjektit se të ardhurat e nënës e kishin burimin nga të ardhurat e fëmijëve të saj, të cilët ishin emigrantë, mbeten në nivel deklarativ dhe nuk u provuan me dokumentacion të rregullt ligjor sipas përcaktimeve të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

6.44. Nga rrethanat dhe faktet, trupi gjykues konstatoi se subjekti nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës, pasi ai dhe personi i lidhur kanë qenë në pamundësi financiare për krijim të depozitës në emër të bashkëshortes në datën 26.12.2006; kanë qenë në pamundësi financiare në vitin 2012 për shtim të depozitave në emër të fëmijëve në Intesa Sanpaolo Bank, duke e përcaktuar atë në situatën faktike të parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

7. Analiza e treguesve financiarë

7.1. Nga analiza e përgjithshme paraprake e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni për periudhën 2003 – 2016, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortit), përveç sa pasqyruar/analizuar më lart, duket se edhe për vitet e mbyllura 2006, 2008, 2009 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime të dokumentuara për blerje/krijim të pasurive, dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/ evidentuara për këto vite, duke rezultuar me balanca negative, në vlerat -475.570 lekë, -289.311 lekë, -1.012.542 lekë dhe -823.661 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

7.2. Subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Në kryerjen e analizës financiare Komisioni është bazuar në faktin se unë nuk kam deklaruar në fund të viteve gjendjen cash, ju lutem rishikoni edhe një herë këtë pjesë të analizës, kjo për faktin se gjendja cash e ndodhur në banesë, e cila është me burim nga të ardhurat, mbulon dhe justifikon tërësisht krijimin e pasurive në çdo vit dhe shmang balancat negative. Gjendja cash në banesë është një gjendje monetare me burim kursimet nga të ardhurat e viteve të mëparshme, që gjatë vitit të deklaratimit ndryshon në varësi të të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera në çdo moment. Gjendja cash në banesë nuk nënkupton që është një depozitë bankare e mbyllur në kasafortë dhe nga e cila nuk mund të përdoret”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.3. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet në seance dëgjimore, arsyeton se:

7.4. Komisioni ka kryer analizën e treguesve financiare për kategoritë pasuri, detyrime, të ardhura dhe shpenzime për periudhën 2003 – 2016, mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, duke analizuar burimin e deklaruar të të ardhurave për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të ndryshme.

7.5. Nga subjekti janë ngritur pretendime për mospërfshirje të kursimeve të llogaritura në fund të çdo viti, në formën e gjendjes *cash* (duke përfshirë edhe vitin 2003 e në vazhdim), të përdorura në vitet ose kohën e blerjes/krijimit të pasurive.

7.6. Trupi gjykues i Komisionit konstaton se këto pretendime nuk janë të mbështetura në deklarin për herë të parë, ashtu edhe në deklaratimet periodike vjetore.

7.7. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, vlerëson se bazuar në pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për kontrollin e

saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimit dhe burimit të ligjshëm të pasurisë, deklaratat periodike kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit.

7.8. Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit vlerën e provës në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe, sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, për të provuar deklarinimet e subjektit mbi gjendjen *cash*.

7.9. Në analizë të deklaratës periodike, subjekti nuk ka deklaruar se ka pasur gjendje *cash*. Duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, si dhe deklarinimet e subjektit mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ.

7.10. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim lidhur me deklarimin e çdo pasurie të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

7.11. Në analizën e treguesve financiarë nga Komisioni, siç është evidentuar edhe më sipër, kursimet *cash* në banesë janë pasqyruar referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur, përcaktimeve në legjislacionin përkatës dhe jurisprudencës së Kolegjit, duke analizuar dokumentacionin ligjor justifikues të burimit të deklaruar, mundësinë financiare për krijimin, si dhe destinacionin e tyre.

7.12. Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimet nr. 29/2019, nr. 11/2019 ka orientuar Komisionin se: *“Për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklarata periodike*

7.13. Në vlerësim të dokumentacionit të disponuar dhe analizës sa më sipër, Komisioni vlerëson se me përjashtim të vitit të mbyllur 2015, për të cilin subjekti ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për vitet e tjera të mbyllura 2006, 2008 dhe 2009 subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit për pamjaftueshmërinë financiare, përkatësisht në vlerat -475.570 lekë, -289.311 lekë, -1.012.542 lekë, duke rezultuar me balancë negative në total në vlerën 1.777.423 lekë.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, në referim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
- b) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur/paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim apo përdorim të tij, në referim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.
- c) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikën 3 të nenit 61 të ligjit

nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Perparim Vukaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.7.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana